

## Dhuna e seksualizuar

Dhuna e seksualizuar ekziston kudo: në jetën publike, në vendin e punës, në internet, por edhe në raport me partnerin dhe në familje. Pas një përdhunimi është e rëndësishme të bëhet një ekzaminim mjekësor, edhe nëse personi i cenuar nuk dëshiron të bëjë një kallëzim tek policia.

### Çfarë është dhuna e seksualizuar?

Dhuna e seksualizuar nënkupton veprime seksuale, për cilat dikush shtyhet ose detyrohet. Disa shembuj janë: ngacmim seksual ose cenime seksuale, shtrëngim seksual, keqtrajtime seksuale në fëmijëri, shfrytëzim seksual ose përdhunim. Dhuna e seksualizuar ndodh edhe në internet. Për shembull, kur incizime intime me video ose foto të partneres ose partnerit shpërndahen pa miratimin e saj/e tij në mediat sociale. Dhuna e seksualizuar ndodh në të gjitha shtresat e shoqërisë dhe në të gjitha grupmoshat dhe mund të cenohet **gjithsecilin**. Dhuna e seksualizuar është e ndaluar në Zvicër dhe dënohet.

### E rëndësishme të dini

Shumica e krimeve seksuale nuk kryhen nga persona të panjohur, por nga partnerët dhe partneret, ish-partnerët dhe ish-partneret, të afërmit dhe kolegët dhe koleget. Personave të prekur shpesh u vjen turp dhe ata vuajnë nga ndjenjat e fajësisë. Nevojitet guxim të kërkonin ndihmë. Sado pas një përdhunimi ka rëndësi, të bëni një ekzaminim mjekësor. Një kallëzim penal tek policia mund të bëhet edhe dikur më vonë.

## Ku gjej ndihmë?

Kur ju ose një person, që e njihni, keni përjetuar dhunë të seksualizuar:

### Ekzaminim mjekësor

Shkoni në ekzaminim mjekësor mundësisht **brenda 72 orëve**.

- Një ekzaminim mjekësor dhe dokumentimi i plagosjeve mund të bëhen në **ordinancën e mjekut tuaj të familjes**.
- Nëse nuk është në dispozicion, ju lutem kontaktoni **numrin emergjent të mjekëve në Aargau**, 0900 401 501 (Fr. 3.23 për minutë, telefon fiks).

### Ekzaminim mjekoligjor

- Spitali kantonal në Aarau ofron ekzaminime mjekoligjore falas për viktime të dhunës fizike dhe seksuale.
- Informacionet tuaja trajtohen **konfidencialisht**.
- Pasojat e dhunës dokumentohen dhe gjurmët sigurohen.
- Nëse viktime e dëshiron, mund të bëhet një kontaktim me zyrën e konsultimit të viktimave në Aargau.
- **Kontakt:** Zyra e ekzaminimit mjekoligjor për viktimat e dhunës, 062 838 64 62.

Orari për kontaktime: të hënën deri të premten ora 8-12 dhe ora 13.30-16.

[www.ksa.ch/gewaltopfer](http://www.ksa.ch/gewaltopfer)

### Sigurimi i provave

- Nëse nuk mund të shkoni drejtpërsëdrejti në ordinancën e një mjeku të familjes ose në një spital, ruani prova si p.sh. rrobat në një thes letre.
- Komunikime Chat dhe mesazhe SMS mund të shërbejnë gjithashtu si prova. Siguroni këto të dhëna.

### Përkrahje shtesë

- Zyra e konsultimit të viktimave në Aargau ofron ndihmë ligjore dhe psikologjike.
- Ajo informon edhe rreth avantazheve dhe disavantazheve të një kallëzimi penal.
- Kostot për trajtimet parandaluese merren përsipër nga institucioni Ndihma për Viktimat pavarësisht nga fakti, nëse bëni një kallëzim penal apo jo.
- **Kontakti:** Zyra e konsultimit të viktimave në Aargau, 062 835 47 90 ose Chat, [www.opferberatung-ag.ch](http://www.opferberatung-ag.ch)

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-aargau.ch/sq/haeusliche-gewalt/sexualisierte-gewalt](http://www.hallo-aargau.ch/sq/haeusliche-gewalt/sexualisierte-gewalt)